

**Msc. Brikena Kullolli**

**Msc. Merita Kollçaku (Pinari)**

# LIBRI I MËSUESIT

**EDUKIM**

**PËR SHOQËRINË**

**2**

Shtëpi Botuese & Shtypshkronjë



BOTIME SHKOLLORE



**Titulli i librit:**

Libri i mësuesit  
Edukim për shoqërinë 2

**Autorë:**

Msc. Brikena Kullolli  
Msc. Merita Kollçaku (Pinari)

**Redaktor letrar:**

Msc. Entela Lace

**Arti grafik:**

Studio grafike FILARA  
Punoi: Enea Ziu

**Botimi i parë:**

FILARA, Tiranë, 2016

© Shtëpia Botuese, FILARA

---

Shtypur në shtypshkronjën: FILARA

**Adresa:**

Rruga "Sabaudin Gabrani"  
Ish - kombinati "Misto Mame"  
Tiranë

Tel: 04 222 88 71 / 04 225 88 01

Cel: 069 33 30 983/069 63 43 532

Cel: 068 50 29 623/069 66 99 693

E-mail: filarabotime@yahoo.com

website: www.filarabotime.com

EDUKIM PËR SHOQËRINË 2  
LIBRI I MËSUJESIT

Reformimi i kurikulës së arsimit bazë sipas qasjes me bazë kompetencat nënkupton mësimdhënie dhe nxënie sipas së njëjtës qasje. Mësuesit, vazhdimisht, gjatë planifikimit të mësimdhënies parashikojnë veprimtari të nxëni, të cilat e lidhin të nxënit me zbatimin e tij në situata jetësore aktuale. Materiali ka si qëllim të ndihmojë mësuesit në konceptimin dhe planifikimin e veprimtarive mësimore që zhvillojnë kompetencat dhe të nxënit gjatë gjithë jetës. Modelet e situatave të përfshira në këtë material shërbejnë vetëm si orientim për konceptimin dhe planifikimin e tyre nga ana e mësuesve.

## KUPTIMI I SITUATËS SË TË NXËNIT

### ➤ Të nxënit me situata

*Të nxënit me situata është të nxënit që ndodh në të njëjtin kontekst në të cilin ai zbatohet.*

Të nxënit me situata i mundëson nxënësit të mësojnë nëpërmjet socializimit, vizualizimit dëgjimit, arsyetimit, reflektimit dhe imitimit. Të nxënit fillon kur ata përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që kanë ose për të zgjidhur probleme.

Të nxënit me situata përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale. Synimi i tij është përmirësimi i të nxënit me anë të motivimit të nxënësve dhe krijimit të një konteksti të pasur të nxëni. Ai vë më shumë theksin te konteksti dhe zbatimi i njohurive se sa te memorizimi i fakteve.

Mësimdhënia vendoset në kontekste autentike që i ndihmon nxënësit të mësojnë nga përvoja reale. Përmes situatave të të nxënit, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë aftësitë dhe t'i përdorin ato saktësisht. Nëpërmjet tyre nxënësit fitojnë përvoja që i zbatojnë gjatë gjithë jetës.

Në procesin e të nxënit me situata, mësuesi nuk shikohet si i vetmi ekspert në klasë. Roli i tij shndërrohet nga “depozita” e dijeve në atë të lehtësuesit dhe udhëzuesit.

Të nxënit me situata përfshin përdorimin në shkallë të lartë të teknologjisë, pasi ajo krijon mundësitë e zëvendësimit të demonstrimeve praktike.

Në situatat ku të nxënit me situata nuk mundësohet, mund të përdoren simulime ose demonstrime.

### ➤ Kompetenca dhe situata e të nxënit

Zhvillimi i kompetencës te nxënësit arrihet kryesisht përmes ndërveprimit të tij me mjedisin e të nxënit. Sa më shumë ai ndërvepron me mjedisin, janë ata faktorë që përcaktojnë zbatimin e kompetencës prej tij. Dihet se kompetenca është e lidhur ngushtë dhe shoqërohet gjithmonë me situatën, familjen e situatave dhe kontekstin ku këto vendosen. E parë në këtë këndvështrim, çdo kompetence i korrespondon një situatë dhe një familje situatash, ku ajo zhvillohet, ndërtohet dhe përsoset. Në trajtimin e situatës, një rol të veçantë luajnë njohuritë dhe përvoja që zotërojnë nxënësit. Zhvillimi i kompetencës gjatë trajtimit të situatës varet nga lloji dhe numri i burimeve, të cilët i gjen dhe i përdor nxënësi. Një kompetencë është e ndërtuar vetëm nëse nxënësi e trajton plotësisht situatën në atë mënyrë që pranohet edhe nga të tjerët. Kompetenca është rezultat i procesit të përkohshëm, dinamik, dialektik dhe ndërtues të trajtimit të situatës; ajo nuk është proces por produkt i situatës.

Kompetenca nuk mund të parashikohet dhe nuk mund të përcaktohet, ajo varet nga nxënësi ose grupi i nxënësve, nga njohuritë dhe përvoja e tyre, nga kuptimi i situatës, nga ajo që mendohet se mund të bëhet në këtë situatë, nga burimet që zotërohen në këtë situatë etj.

Njohuritë që ndërton nxënësi përmes veprimit në situata mund të vihen në zbatim vetëm kur nxënësi i ka të qarta situatat. Situatat janë thelbësore dhe të nevojshme për ndërtimin e njohurive nga nxënësi, por jo të mjaftueshme. Kështu, në fillim nxënësi koordinon veprimet e tij në situatë, pra e trajton atë

në mënyrë kompetente. Pastaj, pasi ka përfunduar në mënyrë të kënaqshme trajtimin kompetent të situatës, nxënësi analizon veprimin e tij duke qenë jashtë situatës. Ai shpreh me fjalë veprimet e tij, flet për atë që ka realizuar, përshtat dhe riorienton veprimet e tij. Nga veprimi kompetent në situatë, nxënësi kalon në reflektimin mbi veprimet duke qenë jashtë situatës. Nëpërmjet këtij kthimi reflektues mbi veprimet e tij, nxënësi mund të shprehë me fjalë, atë që ka realizuar efektivisht në situatë. Për pasojë, përmes këtij shpjegimi, nxënësi koncepton trajtimin kompetent të situatës, e përjeton së brendshmi dhe e përvetëson atë. Ky trajtim kompetent i situatës, i shprehur me fjalë dhe përmes veprimeve, bëhet kompetencë e shpjeguar vetjake. Kjo kompetencë e shpjeguar, më pas mund të përgjithësohet, për t'u përshtatur në situata të reja.

### ➤ Planifikimi i situatës së të nxëniet

Dilemat që kanë mësuesit në përcaktimin e situatave nuk lidhen vetëm me shkallën e qartësisë së përshkrimit të tyre, por dhe sa të kuptueshme e të rëndësishme do të jenë ato për nxënësit. Si mund të barten ato në orën e mësimit, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë kompetencat për të trajtuar situata jetësore? Për zgjidhjen e këtyre dilemave vjen në ndihmë matrica e trajtimit kompetent të situatës.

**Matrica e trajtimit kompetent të situatës (MTKS)**

Situata	Veprimet	Burimet	Vlerësimi
Familja e situatave.	Kategoritë e veprimeve që lejojnë trajtimin kompetent të këtyre situatave.	Burime të ndryshme, të nevojshme për trajtimin e këtyre situatave, përmes veprimeve të përshkruara.	Pritshmëritë për trajtimin e këtyre situatave.
Shembuj situatash që i përkasin kësaj familjeje.	Shembuj veprimesh që lidhen me trajtimin e këtyre situatave.		Shembuj kriteresh.

### ➤ Shpjegimi i MTKS

Në ndihmë të plotësimit të MTKS, jepen shpjegimet e mëposhtme:

#### a) **Situata**

- një situatë, në të cilën do të veprojnë nxënësi ose grupi i nxënësve.
- një familje situatash përbëhet nga disa situata me veti të përbashkëta.

Këtu shkruhet tema e situatës dhe bëhet një përshkrim i rrethanave të saj.

#### b) **Veprimet**

- kategoritë e veprimeve që mund të kryhen nga nxënësit gjatë situatës;
- zbatimin e veprimeve përdorimi i burimeve, strategjitë, teknikat dhe metodat e trajtimit të situatës.

#### c) **Burimet**

- burime vetjake të nxënësve: ata janë kognitive (bagazhi i njohurive të nxënësit), konative (elementet emocionale, motivuese etj.) dhe trupore;
- burime specifike të situatës: këto janë rrethanat e situatës që lehtësojnë trajtimin e saj;
- burime të jashtme: janë burime jashtë situatës që lehtësojnë trajtimin e situatës nga nxënësit.

**d) Vlerësimi**

Kuadri i vlerësimit saktëson:

– *tipin e trajtimit të pritshëm* që situata të trajtohet realisht nga nxënësi dhe të pranohet nga të tjerët.

– *kriteret e vlerësimit të trajtimit kompetent të situatës nga nxënësit.*

Këtu shkruhet si duhet trajtuar situata nga nxënësit që trajtimi i saj të quhet kompetent si dhe kriteret e vlerësimit.

Për konceptimin dhe shkrimin e një situatë, mësuesi ndjek formatin e mëposhtëm.

**➤ Formati i situatës së të nxënësit**

Në planifikimin e një situatë të nxënësi, mësuesi merr parasysh:

1. Rezultatet e të nxënësit (rezultatet e të nxënësit të programit që realizohen nëpërmjet kësaj situatë).
2. Emërtimin e situatës (titulli i situatës).
3. Përshkrimin kontekstual të situatës (përmbajtja e situatës në kontekstin e realizimit të rezultateve të të nxënësit).
4. Veprimet e kryera për trajtimin e situatës.
5. Burimet (mjete, pajisje, burime të ndryshme, njohuritë dhe aftësitë paraprake të nxënësve).
6. Vlerësimin (kur situata quhet e realizuar).

## EDUKIM PËR SHOQËRINË 2

### KOMPETENCAT KYÇE:

#### ➤ **Kompetenca qytetare**

*Programi i edukim për shoqërinë 2, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.*

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së edukim për shoqërinë nxitin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

#### ➤ **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

Programi i edukim për shoqërinë 2 krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj, nxënësi zhvillon shkathtësitë të të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audienca të ndryshme.

#### ➤ **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *edukim për shoqërinë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

#### ➤ **Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

#### ➤ **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara

nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

### ➤ **Kompetenca personale**

Programi i edukim për shoqërinë 2 nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

### ➤ **Kompetenca digjitale**

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

## Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe të lëndës edukim për shoqërinë 2

**Kompetenca qytetare (Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët):** Merr pjesë në aktivitete që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor në shkollë apo në komunitetin ku bën pjesë. Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë.

**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Nxënësi komunikon në mënyrë efektive):** Zhvillon shkathtësi të të shprehurit. Shpreh mendimin e tij rreth një temë të caktuar si me gojë edhe me shkrim. Nxënësi duhet të veçojë informacionin kryesor nga një libër, revistë, gazetë, nga interneti, nga TV dhe e përdor atë gjatë detyrës apo diskutimit të tij. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

**Kompetenca e të menduarit (Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese):** Zhvillon aftësi dhe shkathtësi në marrjen e vendimeve që e ndihmojnë të zhvillojë imagjinatën dhe të jetë krijues në vëzhgimet në terren. Di të ndjekë rrugën e duhur në marrjen e një vendimi. Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore në zgjidhjen e një problemi.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive):** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizuar detyrat e përbashkëta. Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin. Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

**Kompetenca e të nxënimit (Nxënësi mëson për të nxënë)**  
Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike. Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur. Menaxhon kohën dhe emocionet e tij.

**Kompetenca personale (Nxënësi bën jetë të shëndetshme):** Kupton rolin në procesin e të nxënimit dhe aftësohet të jetë i pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive. Bëhet i pavarur në marrjen e vendimeve. Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

**Kompetenca digjitale (Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin):**  
Përdor Tik-un për të lehtësuar procesin e të nxënimit, për të komunikuar dhe bashkëpunuar. Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).



## QËLLIMET E PROGRAMIT TË LËNDËS SË EDUKIM PËR SHOQËRINË 2

Edukimi për qytetari demokratike **synon**:

- Të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, **programi i lëndës së edukim për shoqërinë 2 synon**:

- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

# PLANI VJETOR PËR LËNDËN E EDUKIMIT PËR SHOQËRINË 2

Gjithsej 35 javë x 1 orë = 35 orë

## FORMATI 3

### PLANIFIKIMI VJETOR SHTATOR – QERSHOR 2016 – 2017

#### FUSHA : SHKENCAT SHOQËRORE LËNDA: Edukim për shoqërinë 2

	vetes, të tjerëve, komunitetit.			gjithëpërfshirëse;		klasën e II;
11.	5 orë	2. Të njohim përgjegjësitë tona duke respektuar të drejtat e të tjerëve.	Të gjithë kemi të barabartë në të drejta, por jemi të ndryshëm në aftësi. Përveç të drejtave ne kemi edhe përgjegjësi.	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)	Udhëzues për mësuesin;
12.		3. Si të ndihmojmë të tjerët.	Është e rëndësishme që të ndihmojmë të tjerët që kanë nevojë, kjo tregon qytetari.	Hetimi dhe zbulimi;	vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	Libri i mësuesit
13.		4. E mira e përbashkët.	Secili nga ne ka disa të mira personale, të cilat na përkasin vetëm ne, si: libri, telefoni, rrobat, etj., por ka disa të mira, të cilat i përkasin të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe shoqërisë.	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase	vlerësimi i punës në grup;	Materiale nga interneti;
14.		5. Situatë e sugjeruar 1: Të njohim dhe të respektojmë të drejtat tona dhe ato të të tjerëve.	Të respektojmë të drejtat e të tjerëve, do të thotë të respektojmë dhe të drejtat e tua.	Metoda integruese	vlerësim mes nxënësish;	Materiale nga enciklopedi, revista;
				Bashkëbisedim	vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;	Slide të krijuara nga mësuesit për tema të veçanta.
15.		1. Rregullat	Rregullat janë të shkruara dhe të pashkruara.		vlerësimi i detyrave të portofolit	
16.	<b>Tematika 2: Pushteti, autoriteti, qeverisja</b>  Nëntematika 1	2. Rregullat në mjediset publike.	Mjediset publike u ofrojnë shërbime të shumta njerëzve të tilla, si: argëtim, përkujdesje, u mëson njerëzve norma të sjelljes dhe të vlerave etj. Por edhe këtu duhen zbatuar disa rregulla.	Metoda bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	vlerësim diagnostikues	Teksti "Edukim për shoqërinë" për klasën e II;
17.	Rregullat  4 orë	3. Pasojat e mungesës së rregullave.	Respektimi i rregullave është shumë i rëndësishëm.	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)	Udhëzues për mësuesin;
18.		4. Situatë e sugjeruar 1: "Së bashku për një rregullore më të mirë".	Të gjithë duhet të japim ndihmesën tonë për rregulloren e shkollës.	Hetimi dhe zbulimi;	vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	Libri i mësuesit
19.	Nëntematika 2	1. Rruga dhe përdoruesit e saj.	Rruga është një hapësirë e caktuar mbi të cilën	Zbatime praktike brenda dhe jashtë	vlerësimi i punës në grup;	Materiale nga interneti;
					vlerësim mes	

	vetes, të tjerëve, komunitetit.			gjithëpërfshirëse;		klasën e II;
11.	5 orë	2. Të njohim përgjegjësitë tona duke respektuar të drejtat e të tjerëve.	Të gjithë kemi të barabartë në të drejta, por jemi të ndryshëm në aftësi. Përveç të drejtave ne kemi edhe përgjegjësi.	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)  vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	Udhëzues për mësuesin;  Libri i mësuesit
12.		3. Si të ndihmojmë të tjerët.	Është e rëndësishme që të ndihmojmë të tjerët që kanë nevojë, kjo tregon qytetari.	Hetimi dhe zbulimi;	vlerësimi i punës në grup;	Materiale nga interneti;
13.		4. E mira e përbashkët.	Secili nga ne ka disa të mira personale, të cilat na përkasin vetëm ne, si: libri, telefoni, rrobat, etj., por ka disa të mira, të cilat i përkasin të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe shoqërisë.	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase  Metoda integrale	vlerësim mes nxënësish;  vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;	Materiale nga enciklopedi, revista;  Slide të krijuara nga mësuesit për tema të veçanta.
14.		5. Situatë e sugjeruar 1: Të njohim dhe të respektojmë të drejtat tona dhe ato të të tjerëve.	Të respektojmë të drejtat e të tjerëve, do të thotë të respektojmë dhe të drejtat e tua.	Bashkëbisedim	vlerësimi i detyrave të portofolit	
15.		1. Rregullat	Rregullat janë të shkruara dhe të pashkruara.			
16.	<b>Tematika 2: Pushteti, autoriteti, qeverisja</b>  Nëntematika 1	2. Rregullat në mjediset publike.	Mjediset publike u ofrojnë shërbime të shumta njerëzve të tilla, si: argëtim, përkujdesje, u mëson njerëzve norma të sjelljes dhe të vlerave etj. Por edhe këtu duhen zbatuar disa rregulla.	Metoda bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	vlerësim diagnostikues	Teksti "Edukim për shoqërinë" për klasën e II;
17.	Rregullat  4 orë	3. Pasojat e mungesës së rregullave.	Respektimi i rregullave është shumë i rëndësishëm.	Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)	Udhëzues për mësuesin;  Libri i mësuesit
18.		4. Situatë e sugjeruar 1: "Së bashku për një rregullore më të mirë".	Të gjithë duhet të japim ndihmesën tonë për rregulloren e shkollës.	Hetimi dhe zbulimi;	vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	Materiale nga interneti;
19.	Nëntematika 2	1. Rruga dhe përdoruesit e saj.	Rruga është një hapësirë e caktuar mbi të cilën	Zbatime praktike brenda dhe jashtë	vlerësim mes	

## Edukim për shoqërinë 2

	Rruga 5 orë		lëvizin njerëzit, mjetet e ndryshme dhe kafshët. Rrugët janë të ndryshme	klase	nxënësish;	
20.		2. Shenjat e qarkullimit në rrugë.	Është e rëndësishme që kur lëvizim nëpër rrugë të respektojmë rregullat kryesore të rrugës.	Metoda integrale		
21.		3. Si të jemi përdorues të mirë të rrugës.	Duke njohur rregullat e qarkullimit ne jemi përdorues të mirë të rrugës..	Metoda bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)	Teksti "Edukim për shoqërinë" për klasën e II;
22.		4. Mjetet lëvizëse janë të ndryshme.	Njerëzit sot, përdorin lloje të ndryshme mjetesh për të udhëtuar apo për të transportuar mallra të ndryshme.	Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi;	vlerësimi i përgjigjeve me gojë;	Udhëzues për mësuesin; Libri i mësuesit
23.		5. Situatë e sugjeruar 1: Si të sillemi në rrugë.	Sjellja në rrugë shpesh përfshin situata të rrezikshme.	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase Metoda integrale Bashkëbisedim	vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësimi i aktiviteteve gjatë debateve në klasë; vlerësimi i detyrave të portofolit	Materiale nga interneti; Materiale nga enciklopedi, revista; Slide të krijuara nga mësuesit për tema të veçanta.

## MODELE SITUATASH TË NXËNI

### TEMATIKA 1: Individët, grupet. Shoqëria.

#### NËNTEMATIKA 1.1: Zhvillimi individual, nevojat, dëshirat, të drejtat.

<b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.1: Kush jam unë?</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto e fëmijëve të ndryshëm.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<p><b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i></p> <p><b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i></p> <p><b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i></p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njeh veten;</li> <li>➤ dallon veten nga të tjerët.</li> </ul>		Vetja ime	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b>		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b> Art pamor, Gjuhë dhe komunikim.	
Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme fëmijësh.			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<p><b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto fëmijësh dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.</p> <p><b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit përshkruajnë fotot, mësuesi/ja u kërkon që të përshkruajnë me disa fjali shokun dhe shoqen që kanë në krah.</p> <p><b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Ku ndryshoni ju nga njëri-tjetri?</li> <li>☞ Cilat janë të përbashkëtat që ju keni?</li> <li>☞ Ku dallojnë rolet tuaja shoqërore nga njëri-tjetri?</li> <li>☞ Si janë tiparet tuaja të lindura apo të trashëguara?</li> </ul> <p><b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin veten;</li> <li>- dallojnë veten nga të tjerët.</li> </ul> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.</p>			

<b>Fusha:</b> <b>Shoqëria dhe mjedisi</b>	<b>Lënda: Edukim për shoqërinë</b>	<b>Shkalla: 3</b>	<b>Klasa:II</b>
<b>Tema mësimore 1.2: Të ngjashëm dhe të ndryshëm.</b>		<b>Situata e të nxënit: Foto e familjarëve të nxënësve.</b>	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<p><b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i>  <b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i>  <b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i></p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ zbulon tiparet e përbashkëta me familjarët;</li> <li>➤ krahason veten me të tjerët.</li> </ul>		<p>Të ngjashëm Të ndryshëm</p>	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b>		<b>Lidhje me fushat kurikulare: Art pamor.</b>	
Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<p><b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të tregojnë foto të familjes së tyre që ata kanë sjellë me vete, sipas kërkesës së tij/saj.</p> <p><b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin dallimet dhe ngjashmëritë me familjarët.</p> <p><b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t’i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Cilat janë cilësitë e ngjashme që ju keni me familjarët tuaj? Po të veçantat?</li> <li>☞ Cilat janë cilësitë e ngjashme që ju keni me shokët dhe shoqet?</li> <li>☞ Ku ndryshoni ju nga shokët dhe shoqet? Po nga familjarët tuaj?</li> </ul> <p><b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbulojnë tiparet e përbashkëta me familjarët;</li> <li>- krahasojnë veten me të tjerët.</li> </ul> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.</p>			

<b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.3: Nevojat dhe dëshirat tona.</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto e një biçiklete, libër, det etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<p><b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i>  <b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i>  <b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i></p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njeh nevojat dhe dëshirat e tij;</li> <li>➤ dallon nevojat nga dëshirat.</li> </ul>		Nevojë Dëshirë	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b> Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<p><b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto e një biçiklete, libër, det etj., dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.</p> <p><b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin rreth dëshirave dhe nevojave në foto.</p> <p><b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Cilat janë nevojat që paraqiten në foto?</li> <li>☞ Cilat janë dëshirat që shikoni në foto?</li> <li>☞ Kush është më e rëndësishme për ju nevoja apo dëshira?</li> <li>☞ Cilat janë nevojat tuaja kryesore? Po dëshirat tuaja cilat janë?</li> </ul> <p><b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin nevojat dhe dëshirat;</li> <li>- dallojnë nevojat nga dëshirat.</li> </ul> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.</p>			

<b>Fusha:</b> <b>Shoqëria dhe mjedisi</b>	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.4: Të kuptojmë vlerën e nevojave tona.</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto ushqimi, shkollë, familje etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i>			
<b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i>			
<b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njeh rëndësinë e nevojave të tij;</li> <li>➤ shpjegon rolin e nevojave.</li> </ul>		Vlerë Rëndësi Dashuri Respekt	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b>		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b>	
Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.		Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Përshkrimi kontekstual i situatës;</b>			
Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto ushqimi, shkollë, familje etj., dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.			
<b>Zhvillimi i situatës:</b>			
Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotot.			
<b>Veprimet në situatë:</b>			
Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Cilat janë nevojat që paraqiten në foto?</li> <li>☞ Përse ato janë të rëndësishme për ju?</li> <li>☞ Si ju bën të ndiheni plotësimi i këtyre nevojave?</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i situatës:</b>			
Situata quhet e realizuar kur nxënësit:			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin rëndësinë e nevojave të tyre;</li> <li>- shpjegojnë rolin e nevojave.</li> </ul>			
<b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.			



<b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.5: Plotësimi i nevojave është një e drejtë që më takon.</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto parku, shkolle, qendër kujdesi etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i> <b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i> <b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
➤ njeh rëndësinë e plotësimit të nevojave të tij.		Nevojë E drejtë	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b> Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b> Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto parku, shkolle, qendre kujdesi etj., dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.			
<b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotot.			
<b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove: <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Cilat janë nevojat që paraqiten në foto?</li> <li>☞ Përse ato janë të rëndësishme për ju dhe familjen tuaj?</li> <li>☞ Përse është e rëndësishme që ato të plotësohen?</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin rëndësinë e plotësimit të nevojave të tyre.</li> </ul>			
<b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.			

<b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.6: Të drejtat e mia.</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto fëmijë që studion, që argëtohet, që lyp, që shet etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<p><b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i>  <b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i>  <b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i></p>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njeh të drejtat e tij;</li> <li>➤ vlerëson rëndësinë e respektimit të të drejtave.</li> </ul>		<p>Të drejta Ushqim Mirësjellje Shkollë</p>	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b>		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b>	
Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.		Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<p><b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto fëmijë që studion, që argëtohet, që shet, që lyp etj., dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.</p> <p><b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotot.</p> <p><b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Cilat janë disa nga të drejtat që ju keni?</li> <li>☞ Përse ato janë të rëndësishme për ju?</li> <li>☞ Cilët prej fëmijëve në foto po ju respektohen të drejtat? Cilëve po ju shkelen të drejtat?</li> <li>☞ Përse është e rëndësishme që të drejtat të respektohen?</li> </ul> <p><b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin të drejtat e tyre;</li> <li>- vlerësojnë rëndësinë e respektimit të të drejtave.</li> </ul> <p><b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.</p>			

<b>Fusha:</b> Shoqëria dhe mjedisi	<b>Lënda:</b> Edukim për shoqërinë	<b>Shkalla:</b> 3	<b>Klasa:</b> II
<b>Tema mësimore 1.7: Të drejtat e mia dhe të të tjerëve.</b>		<b>Situata e të nxënit:</b> Foto fëmijë në fshat, në qytet, fëmijë që pushon, që punon etj.	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</b>			
<b>Kompetenca e të menduarit:</b> <i>Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese;</i> <b>Kompetenca e të nxënit:</b> <i>Nxënësi mëson për të nxënë;</i> <b>Kompetenca qytetare:</b> <i>Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.</i>			
<b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore. Nxënësi:</b>		<b>Fjalët kyçe:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ njeh të drejtat e tij;</li> <li>➤ njeh dhe respekton të drejtat e të tjerëve.</li> </ul>		Të drejtat e mia Të drejtat e të tjerëve	
<b>Burime dhe mjete mësimore:</b>		<b>Lidhje me fushat kurikulare:</b>	
Teksti i Edukim për shoqërinë 2, foto të ndryshme.		Gjuha dhe komunikimi.	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>			
<b>Përshkrimi kontekstual i situatës:</b> Mësuesi/ja u tregon nxënësve disa foto fëmijë në fshat, në qytet, që pushon, që punon etj., dhe u kërkon t'i përshkruajnë ato.			
<b>Zhvillimi i situatës:</b> Pasi nxënësit tregojnë fotot mësuesi/ja u kërkon që të diskutojnë me njëri-tjetrin për fotot.			
<b>Veprimet në situatë:</b> Nxënësit punojnë në grupe, dhe mundohen t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme, rreth fotove: <ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Çfarë vini re në këto foto?</li> <li>☞ Cilat të drejta janë respektuar? Cilat janë shkelur?</li> <li>☞ Përse është e rëndësishme të respektohen të drejtat e njëri-tjetrit?</li> </ul>			
<b>Vlerësimi i situatës:</b> Situata quhet e realizuar kur nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohin të drejtat e tyre;</li> <li>- njohin dhe respektojnë të drejtat e të tjerëve.</li> </ul>			
<b>Detyrë shtëpie:</b> Rubrika: Detyrë.			

